



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 20 qershor 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit nga data 1 deri më 19 korrik 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë(huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit) dhe bankës KfW Frankfurt am Main për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermeni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Ditmir Bushati, Evis Kushi, Elona Hoxha, Reme Lala dhe Ervin Bushati

Mungojnë:

Ralf Gjoni, Rudina Hajdari, dhe Ligoraq Karamelo.

Të ftuar:

Leonard Miloti – Koordinator Projektsh pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Brikena Jazxhi – Specialiste në Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme me këto çështje në rendin e ditës: miratimi i procesverbalit të datës 20.06.2019, miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit nga data 1-19 korrik 2019, si dhe shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë(huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit) dhe bankës KfW Frankfurt am Main për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

Të ftuar për të folur rreth këtij projektligji kemi zotin Miloti, përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, dhe zonjën Jazxhi, specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilëve u uroj mirëseardhjen!

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të datës 20.06.2019.

Nëse jeni dakord dhe nuk keni asnjë vërejtje, e konsideroj të miratuar procesverbalin.

Faleminderit!

Vijojmë me miratimin e draftkalendarit të punimeve të komisionit deri në fund të sesionit.

Ka vërejtje nga kolegët? Nëse jeni dakord, ju falënderoj!

Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Zoti Miloti, do ta prezantoni ju projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, shkurtimisht dhe në mënyrë shteruese, sepse riktheheni me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për fazën e katërt.

Fjala është për ju.

Leonard Miloti – Faleminderit!

Marrëveshja qeveritare është diskutuar edhe më parë, ndërkohë që tani ...

Mimi Kodheli – Vazhdoni, sepse regjistrohet çdo gjë që thoni.

Leonard Miloti – ...vjen miratimi i marrëveshjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Funksionon parlamenti, se mos kishit ndonjë dyshim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard Miloti – Jo, jo, nuk kam asnjë dyshim!

(Ilaritet në sallë.)

Në tërësinë e tij, programi IV, si zona do të ndërhyjë në Himarë dhe në Orikum, ku popullsia përfituese është rreth 80 mijë banorë. Situata aktuale e furnizimit...

Mimi Kodheli – 80 mijë banorë?!

Leonard Miloti – Po.

Situata aktuale e furnizimit me ujë është kritike, për arsye të gjendjes së rrjetit, i cili është tejet i amortizuar dhe i ndërtuar që nga viti 1964 ka pasur ndër vite disa ndërhyrje, por asnjëherë ndërhyrje në nivelin që kërkohet sot: furnizim me ujë 24 orë, që është edhe qëllimi i programit.

Në tërësinë e tij programi është 40 milionë euro, pjesa e kredisë, por ka edhe komponentë të tjerë, siç janë masat shoqëruese dhe konsulenca për projektimin dhe supervizionin. Ky program parashikohet të implementohet në një periudhë pesëvjeçare, ndërkohë që impakti i pritshëm për ndërtimin e këtyre skemave të ujësjellësve është në vitin 2021.

Aktualisht, nëse ecuria do të jetë e mirë, me miratimin e marrëveshjes, projektimi (dizajni) do të përfundojë në vitin 2020 dhe rreth muajve gusht ose shtator të vitit të ardhshëm do të fillojnë procedurat e tenderimit të punimeve. Ndërsa për sa u përket impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, ato do të kenë një afat më të gjatë, sepse është parashikuar një periudhë dyvjeçare për ndërtimin e tyre, për arsye të kompleksitetit të punës që kanë ose të specifikave që ka ndërtimi i impianteve. Pritet që në vitin 2021 deri në vitin 2022 të ketë përfunduar impianti i Himarës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I përpunimit të ujërave të ndotura.

Ky impiant ka një kapacitet prej 36 mijë personash, ndërsa impianti i Orikumit, i cili është ekzistues, por do të vihet në punë, ka një kapacitet më të madh, prej 53 mijë personash.

Kjo është e përgjithshmja për programin.

Nëse do të ketë pyetje nga anëtarët e komisionit, shprehem i hapur.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Miloti!

Ka pyetje?

Adnor Shameti – Kur do t'i bëjmë fshatrat tona me këto projektet e FSHZH-së?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm këtej nga Bregu...

(Diskutime në sallë)

Mimi Kodheli – Meqenëse kolegët nuk kanë pyetje, sepse janë të gjithë të sqaruar, unë kam disa.

E para, a është llogaritur shtimi i banorëve në momentet e pikut të turizmit? Sepse ju thoni që ka kaq banorë, në një kohë kur numri i banorëve shtohen në nivele të konsiderueshme: dyfishohen, trefishohen, katërfishohen ose më shumë se kaq gjatë periudhës së pikut. A është parashikuar kjo dhe a ka një studim lidhur me tendencën e shtimit të objekteve të banimit ose të hotelerisë, ose ditore në këtë zonë? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë. Unë di se ndërhyrja në rrjetin e vjetër të ujësjellësit është diçka, ndërsa depurimi i ujërave të zeza është një rrjet që do të ndërtohet nga e para, për aq kohë sa njerëzit, që kanë banuar në këto fshatra ose qyteza asokohe kanë pasur pastrim të kanaleve të ujërave të zeza nëpërmjet gropave septike. Pse këto dy projekte nuk ecin paralelisht dhe pse është më e vështirë të ngresh kapacitete për depurimin e ujërave të zeza, krahasuar me rrjetin e ujërave të bardha? Pse e them këtë? Sepse, pavarësisht mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë në këto zona, gjithsesi dhe pavarësisht konsumit të rrjetit, kjo funksionon.

Në gjykimin tim modest, problemi i ndotjes së detit apo i mjedisit është më emergjent, dhe këtë e shtroj edhe në formë pyetjeje, edhe në formë provokimi pozitiv, sesa vetë ujërat e bardha.

Leonard Miloti – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen e parë, në tetor të vitit 2018 ka përfunduar konsulenca për hartimin e fizibilitetit teknik për ujësjellësin dhe për impiantin e ujërave të ndotura. Janë marrë në konsideratë...

Mimi Kodheli – Po i jepni përgjigje pyetjes sime të dytë?

Leonard Miloti – Pyetjes së parë.

Është marrë në konsideratë shtimi i popullsisë, pra numri i banorëve rezidentë, që sot në pikun e tyre është 19 100 banorë, flas për Himarën, ndërsa shtimi i popullsisë nënkupton edhe 30 mijë të tjerë. Pra, kjo zonë ka 50 mijë banorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kështu edhe për Orikumin, është marrë në konsideratë popullsia rezidente dhe shtimi deri në vitin 2038-2040.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, shtimi i popullsisë është marrë në konsideratë nga fizibiliteti.

Mimi Kodheli – Në rregull.

Leonard Miloti – Për sa i përket prioritetit të ujësjellësit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura pse jemi më dobët tek impiantet e trajtimit të ndotura dhe pse kërkon më

shumë kohë, specifika është e tillë që impianti kërkon më shumë punë në ndërtimin e tij sesa ujësjellësi. Punimet fillojnë paralelisht tek të dyja, por koha e ndërtimit të impiantit...

Mimi Kodheli – Kohëzgjatja.

Leonard Miloti – Po, kohëzgjatja është më e madhe, është dy vjet.

Mimi Kodheli – Pra, projektimi është paralelisht, studimi i fizibilitetit është paralelisht, tenderimi është paralelisht...

Leonard Miloti – Projektimi është paralel, tenderimi...

Mimi Kodheli – Ndërkohë, kohëzgjatja e zbatimit...

Leonard Miloti – Është dy vjet.

Mimi Kodheli – ...është më e madhe.

Leonard Miloti – Po, dhe ka një specifikë: impianti i trajtimit të ujërave të ndotura do të ketë gjatë gjithë kohës nevojë, edhe një vit më shumë, për masa shoqëruese për ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrjes, sepse ndërmarrja “sh.a” e Himarës është ndër më të dobëtat në Shqipëri. Edhe këtu është parashikuar që ka një grant prej 1,5 milionë eurosh, që do të kalojë më vonë.

Mimi Kodheli – Do të kalojë për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard Miloti – Për ngritjen e kapaciteteve të këtyre dy ndërmarrjeve, që është edhe arsyeja pse zgjat më shumë.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndonjë koment ose diskutim nga kolegët?

Po, zoti Sterjovski.

Vasil Sterjovski – Ju thatë që kjo fazë bëhet vetëm për Himarën dhe Orikumin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë vetë jam nga Bashkia e Pustecit, besoj e dini se ku ndodhet, në qarkun e Korçës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe Pusteci ka probleme të mëdha të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime, ku nga nëntë fshatra të bashkisë, vetëm dy kanë ujësjellës dhe ato janë rrjete të amortizuara, por, të paktën, kanë nga dy-tri orë ujë në ditë, ndërkohë që fshatrat e tjerë nuk kanë fare ujësjellës, as kanalizime, as ujë të pijshëm, pavarësisht se gjenden buzë liqenit.

Gjithashtu, kemi edhe një fshat, Zaroshkë, që është përfshirë në projektin “100 fshatrat” turistike, ku edhe atje nuk ka fare ujësjellës, ndërsa kanalizime po. A është parashikuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ndonjë investim për atë zonë, për atë bashki?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht se është zonë turistike e shpallur, është park kombëtar dhe është në kufi me dy shtete: edhe me Greqinë, edhe me Maqedoninë, pra ka një pozicion strategjik, është lënë pas dore të gjitha këto vite për sa i përket ujësjellësit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atje ka edhe një ndërmarrje ujësjellësi, që është krijuar me ligjin e ri, por, normalisht, me dy fshatra, si mund të funksionojë? Pra, duhet që edhe UK-ja të mbështetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Fjala është për ju, zoti Miloti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, prisni t’jua jap unë fjalën!

Leonard Miloti – Marrëveshja, që diskutohet sot, e ka kuadrin ose zonën të përcaktuar, pra Bashkia e Pustecit ose bashki të tjera nuk janë të përfshira.

Për sa i përket fshatit që përfshihet në projektin “100 fshatrat”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit po punon për implementimin e këtij programi dhe ai fshat do të përfitojë jo vetëm ujësjellës, por të gjitha veprat e infrastrukturës inxhinierike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është aq sa mund të them unë, sepse unë mbuloj vetëm programin e ujësjellësve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për Zaroshkën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Fjalën e ka kolegu Hyseni, i cili ka një koment.

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së bashku me zotin Marto jemi deputetë të qarkut të Vlorës dhe gjejmë rastin ta falënderojmë Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që ka përfshirë Himarën dhe Orikumin në këtë projekt të rëndësishëm, pasi domosdoshmëria e këtij projekti është kaq e evidente, sa që ne e shkelim, e prekim përditë në kontaktet me njerëzit atje!

Unë kisha ndërtuar në mendje disa pyetje, përgjigjet e të cilave i mora nga shpjegimet që iu dhanë pyetjeve të kryetares, por do të doja të dija: në vijim të projektit të zonave rurale III, ku ka qenë parashikuar edhe Delvina, që, për pamundësi të bashkisë për të mbuluar pjesën e saj, u skualifikua nga kjo vepër, a është i mundshëm rekuperimi i asaj bashkie në projektet e ardhshme dhe çfarë procedure duhet të ndjekim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Po, zoti Miloti.

Leonard Miloti – Faleminderit!

Është e vërtetë, Bashkia e Delvinës është përzgjedhur në programin rural III, por, për arsye të mosplotësimit të kontributit lokal, është skualifikuar ose është përjashtuar nga ky investim, nga ky program.

Mundësia për ta përfshirë në programin IV nuk ekziston. Nuk e di nëse do të ketë një program të pestë me KfW-në ose në vijimësi, por kjo është jashtë mundësive të mia për ta shpjeguar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti Miloti, t’ju bëj një pyetje? Po shoh investimet që po bëni ju, dhe është gjë shumë e mirë, por, duke marrë shkas nga pyetjet që ju bëri kolegu nga Pusteci, a keni ndonjë plan për t’i mbuluar me sistemin e ujërave të pastra të gjitha këto 100 fshatra atje, ku mungon?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Po, zoti Miloti.

Leonard Miloti – Vitin e kaluar Fondi Shqiptar i Zhvillimit i ka marrë të gjitha aplikimet nga të gjitha bashkitë e vendit, duke përjashtuar Bashkinë e Konispolit dhe atë të Elbasanit, të cilat nuk kanë aplikuar. Në total kanë aplikuar 59 bashki. Është një listë e gjatë aplikimesh, ku çdo bashki ka propozuar tri deri në pesë prioritete. Mbi bazën e këtyre kërkesave, janë vendosur edhe kriteret nga KfW-ja dhe është hartuar një rankim i të gjitha prioriteteve. Kjo listë do të ndiqet në të gjitha programet që mundet Fondi të implementojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aktualisht, ne jemi te 33 objektet ose prioritetet e para. Nëse do të ketë një program tjetër në vijim, kjo listë është në fuqi. Pra, me KfW-në është kjo listë dhe do të vazhdohet nga numri 34 e me radhë.

Adnor Shameti – Një listë e tipit: “Më ka çu nana me la gojën”?!

Vasilika Hysi – Kur ju thoni: “Nëse do të ketë”, nuk mund të bëni vetë një program, ku të kërkonti edhe grante?

Leonard Miloti – Ne kemi aplikuar te WBIF-i për një fazë tjetër, por kemi fituar vetëm një pjesë që ka të bëjë me asistencën teknike ose me projektimin.

Për sa i përket zbatimit, nuk kemi shpallur fitues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Domethënë, no money, no funny!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasil Sterjovski – Bashkitë kanë aplikuar me projekte, apo me kërkesa?

Leonard Miloti – Bashkitë kanë aplikuar vetëm me kërkesa.

Vasil Sterjovski – Projektet i hartoni ju?

Leonard Miloti – Projektet hartohen në një fazë tjetër.

Vasil Sterjovski – Nga ana juaj.

Leonard Miloti – Nga konsulenca, po.

Mimi Kodheli – Mirë, kolegë, unë mendoj që jemi të qartë edhe për pyetjen e fundit. Kështu që e hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligji.

Faleminderit për prezencën të gjithëve!

Punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit juve!

MBYLLET MBLEDHJA